

1

Berisha prek fundin, baskitet edhe nga grupi i deputeteve të Follorës, nga Topalli, Nohuni dhe 44 një demokratë e referendumi

2

Xhaçka për Report Tv: 5200 FA në terren, u kemi kërkuar ndihmë për pajisje mjekësore vendore anëtare të NATO-s (VIDEO)

3

Atentat në Fushë Krujë, qëllimet me bashkëri kallashnikov në drejtim të një makine, plagosën 2 personal

4

Rama bashkëbisedim me demokratët, Akele 'Ishori' gojë, Demokratëve nuk iu ha fare Edi për Edin

5

Pëqin, policia zbulon arsyet e armish dhe drogë në një magazinë! Në pranga 3 persona, 1 në kërkim

Armët mund të jenë përdorur në vrasje dhe krime të tjera

Kronikë


Atentat në Tiranë, i vihet tritolit makinës së biznesmenit të arrestuar më parë për tentativë vrasje! Plagoset rëndë ai dhe punonjësi i tij, pasagjer në mjet

Një atentat me C4 në makinë iu bë biznesmenit Mikel Harizaj i cili u plagos rëndë bashkë me kamarierin e tij Serini Dumi. Sipas policisë shënjestër ishte Harizaj, i arrestuar më herët për tentativë vrasje

- Biznesmeni që iu bë atentat në Tiranë i arrestuar në 2009! Tentoi të vriste 3 persona me granatë
- Atentati në Tiranë, dy personat e plagosur në gjendje të rëndë te 'Trauma'! Kanë marrë plagë të shumta në pjesën e poshtme të trupit

Sokol Dema

7 Janar, 07:25 | Përditësimi i fundit: 7 Janar, 16:14



[Sh]

LEXO EDHE

Tërmet 5.5 ballë në Greqi, lëkundjet ndihen në disa qytete të vendit! Nuk raportohet për dëme materiale! Sizmologu Rrapo Ormeni për Report Tv: S'ka vend për panik!

2022 ka nisur me një sërë ngjarjesh kriminale në vend. Kryeqyteti u trondit pak ditë më parë nga një atentat me armë zjarri, ku mbeti i vdekur **Erion Çela** si dhe 4 të tjerë u plagosën. Po ashtu në qytetin e Vlorës janë shënuar dy ngjarje të rënda kriminale, por për fat të mirë pa viktima. Më 3 janar, makinës në pronësi të **Bernard Sinomatit**, iu vendos tritol, ku si pasojë janë regjistruar dëme të shumta materiale, por fatmirësisht nuk ka pasur persona të lënduar. Vetëm dy ditë më vonë, një atentat me kallashnikov, ndodhi sërish në qytetin bregdetar, ku mbeti i plagosur 36-vjeçari **Diego Hanaj**. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur për motive hakmarrje. Sakaq edhe në Shkodër, u plagos me armë zjarri pas një atentati mafioz **Vincens Piroli**, i shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje nga Mali i Zi. Deri tani nuk ka asnjë ngjarje të zbardhur nga policia, dhe asnjë autor të arrestuar!

Rendit zhvillimet sipas orarit:

Te Fundit

Ora 15:48

Atentati në Tiranë/ Del fotoja, kjo është makina ku iu vu tritolit biznesmenit



Kjo është makina tip Mazda që iu vu sot tritolit. Mjeti është në pronësi të Mikel Harizaj, pronar i një lokali dhe një marketi. Lënda plasëse ishte vendosur nga krahu i shoferit, ku dhe shihet që ka marrë dëmtime më të mëdha në pjesën e përparme.



Ora 10:07

Atentati në Tiranë, objektiv dyshohet 42-vjeçari Mikel Harizaj, pronar i një lokali dhe një marketit! 26-vjeçari punonjësi i tij, po e çonte në shtëpi kur shpërtheu tritolit



42-vjeçari Mikel Harizaj dyshohet se ka qenë objektiv i atentatit me tritol ditën e sotme në Tiranë, ku mbeti i plagosur ai si dhe 26-vjeçari Serini Dumi. Mësohet se lënda plasëse ishte vendosur nga krahu i shoferit, ndërsa nuk dihet ende nëse ka qenë shpërthim i komanduar me telekomandë.

Harizaj rezulton pronar i një lokali në zonën e Xhamllikut si dhe i një marketi po në këtë zonë. Dumi, që ishte pasagjer në makinë, punon kamarier në lokalin e 42-vjeçarit, ndërsa mësohet se në momentin ku ka shpërthyer lënda plasëse, Harizaj po e dërgonte atë në shtëpi.



Ora 09:50

Atentati në Tiranë, dy personat e plagosur në gjendje të rëndë te 'Trauma'! Kanë marrë plagë të shumta në pjesën e poshtme të trupit



Mikel Harizaj dhe Serino Dume, dy personat të cilëve iu bë atentat ditën e sotme në Tiranë, ndodhen në gjendje të rëndë në Spitalin e Traumës, ata janë në intubim në reanimacion, ndërsa kanë marrë dëmtime të shumta në pjesën e poshtme të trupit, në gjymtyrë. Harizajt dhe Dumes iu bë atentat me tritol në orët e para të mëngjesit të sotëm, ku automjeti tip 'Mazda' me të cilin ata udhëtonin u hodh në erë nga shpërthimi.



Ora 08:02

Iu bë atentat me tritol në Tiranë, i plagosuri me precedent penal! Tentoi të vriste 3 persona me granatë

Mikel Harizaj, 42 vjeç, të cilit iu bë atentat gjatë orëve të para të mëngjesit në Tiranë, është një emër i njohur për policinë. Ai është arrestuar në 2009 pasi akuzohet se pas një sherri në lokal, ka tentuar të vrasë 3 persona duke u hedhur një granatë. Ai u arrestua në Selenicë të Vlorës.

Si ndodhi ngjarja? Harizaj, për motive të dobëta është konfliktuar me tre shtetas në ambientet e një lokali. Menjëherë pas konfliktit, Mikel Harizaj ka dalë nga lokali dhe ka shkuar në makinën e tij, të cilën e kishte të parkuar afër lokalit nga ku ka marrë një granatë dore, me të cilën ka sulmuar shtetasit e mësipërm. Nga shpërthimi i granatës është plagosur rëndë shtetasi G. A., dhe më lehtë dy të tjerët.



Ora 07:53

Iu hodhën makinën në erë në Unazën e Re, kush është shoferi dhe pasagjeri që mbetën të plagosur

Mikel Harizaj 42-vjeç dhe Serino Dume 26-vjeç, përkatësisht shoferi dhe pasagjeri, janë dy personat që mbetën të plagosur nga tritolit që i vendosën makinës së tyre mëngjesin e sotëm në zonën e Unazës së re.



M.Q./B.K./Shqiptarja.com

TAG:

Tiranë

policia e tiranes

shperthim me tritol

mikel harizaj

serini dumi

Komento

Vlonjati:

07/01/2022 22:17

Do ta ket ber ndonje vella i atyre femrave qe ka pat nxjerr ne rruge ne greqi e torino ,korrka e kermes

Përgjigju

polic:

07/01/2022 13:12

nuk ka dite qe mos te kete atentate me vdekje e plagosje...e nuk ka ngjarje qe komentuesit ja vene fajin QEVERISE. o popull po mir mor jahu po pse nuk fajsoni nje here kriminelet qe vriten e vrasin per punet e pista e per hakmarrjet ndermjet tyre.qeverija ka faj qe nuk i shiton vitet e denimeve per cdo lloj krimi por nk ka faj qe vriten se te ishte ashtu duhet ti veje nga nje polic cdo kriminel per ti mbrojtur nga kundersharetet e tyre kriminele.lerini budalligjet e filloni hapni syte se jemi populli me kafshe mbas talebaneve.me vjen keq vetem per te pa FAJSHMIT qe gjenden ne mes te ketyre atentateve

Përgjigju

Gripi:

07/01/2022 10:39

Rena ne aksion mbreme ne Shkoder, Fier, Vlore dhe keta godasin ne zemer te tiranes. A ka polici kriminale ky vend apo jo? A ks polici rendi? Do beje reformen ky drejtori i ri duke shporrur nga policia te gjith drejtuesit kanibistet te Saje Qorrit, te paafitet, te inkriminuarit? Do ndeshkohen keta dhe ata qe kane qene perpara ketyrr per korupsionin, bashkepunimin me krimin? Apo do i shohim neses si bashkesmene?

Përgjigju

Beni:

07/01/2022 09:17

Mirmengjes... Se mos beni ndonje dite pushime o njerez! Ju jeni popull per kafaz, sjeni njerez, Duhet me ju mbajt ne kopesht zoologjik, Po ska shtet se ashtu e meriton 50 % Ne shettije te lire duhet te rrine vetem ata Qe jane te denje te jetojne dhe e njohin jeten Dhe lumturine, qe punojne dhe bashkepunojne Me njeri tjetrin... Jo ju kafshe te egra pa tru. Plera

Përgjigju

E ka fajin shteti:

07/01/2022 09:10

Shteti duhet te Hegji gjykimin e shkurtuar. Dhe te kthej në parlament demimim per armbatje paleje 18 vjet . Per Arme te ftofta 12 vjet pa drejt shkurtimi . Dhe kush kryen vepër penale te perseritur 30 vite.dhe pastaj shikojeni ju keta trima ... se te gjith krimet në shqiperi mbi 90% perseriten nga njers me pecedent penal te me parsheim. Se ja kan marr doren drejtjesi.

Përgjigju

Shteti:

07/01/2022 10:55

Sduhet te egzistoj gjykimi i shkurtuar Dhe hegie 3-4 muaj ne vit per shjellje te mire ne burg. Dhe per me keq, sherbim prove dhe pune ne komunitet. Kto sduhet te egzistojne, duhet vetem burg pa afat dhe pa drejte apelimi per kto kafshe parahistorike, Qe si do as familja, i kan rende dhe tokes. Kafaz dhe te izoluar pa respekt minimal. Te merret database e kontigjenteve dhe te behen kontrolle Te befasishme ne lagje ne makina dhe ne banesa Per te pare veprimtarine e tyre, dhe do shikoni rezultatat, Agjentet te paguhen mire dhe te bejne punen sic e kane bere.. Dhe populli do jetoje i qete. Se po kemi frike me dale me familjet, nga bombat e kallashet Ne cdo qytet si ne lufte, na ka zilli dhe Siria e afganistani.

Ndaloheht reptsisht ribupublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

COM

Sondazhi i ditës:

Basha apo Berisha, kush fitoi nga protesta e dhunshme e 8 janarit?

Basha

Berisha

Asnjëri

Lajme të tjera

Sociale

Ministria e Shëndetësisë: Qendra e re Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese, standard i ri shërbimi për fëmijët me aftësi ndryshe

9 Janar, 13:52

Sociale

Veliaj pret kryebashkiakun e Prishtinës, Përparim Rama dhe i jep Çelësin e Tiranës: Çelim një kapitull të ri bashkëpunimi

9 Janar, 13:28

Politike

'Lufta' mes demokratëve dhe shkatërrimi i selisë blu, Meta 'harron' realitetin politik dhe arratiset në natyrë

9 Janar, 13:03

Sociale

Përparim Rama dhe Veliaj ndjekin shfaqjen e kastit të përbashkët të aktorëve 'Unë, Mephisto': Ky bashkëpunim, një mrekulli

9 Janar, 10:42

Kronikë

Kanali që merr jetë njerëzish në rrugën Kavajë-Rrogozhinë! Banorët apajë-ARRSH-Së: Të ndërhijë menjëherë

9 Janar, 09:09

Kronikë

Protesta e dhunshme, 11 të arrestuar, mes tyre demokratë brenda PD dhe shoqëruar, 8 janë të mitur! 7 qytetarë shkuan në spitalë

8 Janar, 17:57